



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.77 / 16 gusht 2010), të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L -150 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 10 / 03 prill 2017), si dhe bazuar dhe në zbatim të neneve 26, 30, 31, 34, 35 dhe 85 të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucioneve Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr.11 / 11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore në mbledhjen e mbajtur më 25 nëntor 2024, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR DREJTORËT DHE MENAXHERËT E LARTË TË BANKAVE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kritereve dhe standardeve “i/e përshtatshëm dhe i/e duhur” për Drejtorët dhe Menaxherët e Lartë si dhe pavarësinë e Drejtorëve, për të cilët kërkohet miratimi paraprak nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), gjatë procesit të licencimit të bankave dhe gjatë shqyrtimit të kërkesave për miratim të tyre në çdo kohë.
2. Kjo rregullore gjithashtu përcakton kufizimin e nivelit të aksioneve që Drejtorët e pavarur mund të zotërojnë drejtpërsëdrejti apo në mënyrë indirekte në bankë, në mënyrë që të ruhet pavarësia e tyre, siç është rregulluar me nenin 26 të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (në vijim: *Ligji për Bankat*).
3. Kjo rregullore aplikohet për të gjitha bankat e licencuara nga BQK-ja, përveç neneve 4 dhe 5 të kësaj rregulloreje, të cilët nuk aplikohen për degët e bankave të huaja siç është përcaktuar me nenin 26, paragrafi 4 të Ligjit për Bankat.

Neni 2

Përkufizimet

Termet e përdorura në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim siç përcaktohen në nenin 3 të Ligjit për Bankat.

Neni 3

Kriteret ‘i/e përshtatshëm dhe i/e duhur’ për Drejtorët dhe Menaxherët e Lartë

1. Asnjë person nuk mund të bëhet drejtor/e ose menaxher/e i/e lartë i një banke pa marrjen e miratimit paraprak të BQK-së.

2. Asnjë person nuk mund të riemërohet drejtor/e ose menaxher/e i lartë i një banke pa marrjen e miratimit paraprak të BQK-së.
3. BQK-ja i kushton rëndësi të veçantë përshtatshmërisë së Drejtorëve dhe Menaxherëve të Lartë të propozuar të bankës përgjatë gjithë procesit të licencimit dhe mbikëqyrjes së bankave.
4. Përveç kërkesave të nenit 35 të Ligjit për Bankat, BQK i aplikon kriteret e mëposhtme, për të bërë vlerësimin para se të japë miratimin e saj për emërimin dhe riemërimin e çdo drejtori/e dhe menaxheri/e të lartë të bankave:
 - 4.1. **Integriteti** - Drejtorët dhe Menaxherët e Lartë kërkohet të jenë individë me reputacion të mirë, të jenë të ndershëm dhe me integritet. Gjatë vlerësimit të reputacionit, ndershmërisë dhe integritetit, BQK-ja do të konsiderojë së paku faktorët si në vijim:
 - 4.1.1. çdo dëshmi nëse personi ishte përgjegjës për mosbashkëpunim apo mosofrimin e informatave të kërkuara, në marrëdhëniet e tij/saj me autoritetet kompetente;
 - 4.1.2. çdo dëshmi për refuzim, revokim apo ndalesë e të drejtës për të ushtruar veprimtari biznesore dhe/ose profesionale;
 - 4.1.3. arsyet për çdo largim nga puna apo nga ndonjë pozitë e mirëbesimit;
 - 4.1.4. diskualifikimi nga autoriteti kompetent rregullator nga ushtrimi i pozitës si anëtar i organeve qeverisëse ose udhëheqëse /ekzekutive të një entiteti;
 - 4.1.5. çdo provë, dëshmi dhe informacione të besueshme se personi ka kryer veprime që nuk janë në përputhje me standardet e mirësjelljes të përcaktuar me Kodin e Etikës apo rregullën e brendshme të Bankës; dhe
 - 4.1.6. çdo gjetje relevante nga ekzaminimet e BQK-së apo të institucioneve/entiteteve tjera relevante.
 - 4.2. **Gjykimi i shëndoshë** - Drejtorët dhe Menaxherët e Lartë duhet të kenë kualifikimet e duhura formale dhe aftësi profesionale që i mundësojnë atyre, që në mënyre kritike dhe adekuate të vlerësojnë politikat dhe çështjet strategjike të bankës. Drejtorët dhe Menaxherët e Lartë duhet të angazhohen në mënyrë aktive në detyrat e tyre dhe duhet të jenë në gjendje të marrin vendime të arsyetuara dhe të gjykojnë në mënyrë të shëndoshë, objektive dhe të pavarur gjatë ushtrimit të funksionit dhe përgjegjësive të tyre.
 - 4.3. **Udhëheqja** - Drejtorët dhe Menaxherët e Lartë duhet të kenë aftësi për të udhëhequr institucionin, të zhvillojnë dhe promovojnë punën ekipore, motivojnë dhe inkurajojnë burimet njerëzore në dispozicion dhe të sigurojnë që punonjësit të jenë profesionalisht të aftë për të arritur objektivat. Ata duhet të jenë të hapur ndaj kritikave dhe të ofrojnë hapësirë për debat.
 - 4.4. **Kompetenca** - Drejtorët dhe Menaxherët e Lartë duhet të kenë nivelin dhe profilin e arsimimit dhe përvojës profesionale përkatëse lidhur me shërbimet bankare dhe financiare ose fusha të tjera relevante me shërbimet bankare dhe financiare. Për këtë qëllim, Drejtorët dhe Menaxherët e Lartë duhet t'i plotësojnë kriteret si në vijim:
 - 4.4.1. të kenë diplomë universitare në drejtimit si banka dhe financa, ekonomi, jurisprudencë, kontabilitet, auditim, administrim biznesi, teknologji informative apo drejtime tjera që mund të konsiderohen relevante për pozitën në të cilën emërohen;

- 4.4.2. të kenë përvojën profesionale prej së paku shtatë (7) vite në fushën bankare dhe/ose financiare nga të cilat së paku tri (3) vite duhet të jenë në pozita udhëheqëse/menaxheriale ose jo më pak se dhjetë (10) vite përvojë profesionale në fushën bankare dhe/ose financiare përkatëse, relevante për pozitën në të cilën emërohen;
- 4.4.3. të kenë njohuri të përditësuara për veprimtarinë bankare dhe rreziqet e sektorit bankar, në një nivel proporcional me përgjegjësitë e tyre;
- 4.4.4. të kenë njohuri për qeverisjen e institucionit, rolin dhe përgjegjësitë e tyre përkatëse.
- 4.5. **Qëndrueshmëria financiare** – Drejtorët dhe menaxherët e lartë duhet të dëshmojnë përmbushjen e shpejtë të obligimeve të kaluara financiare dhe gjendjen ekzistuese të shëndoshë financiare.
5. Përveç dokumentacionit/dëshmimeve që vërteton plotësimin e kriterëve nga paragrafi 4 i këtij neni, BQK-ja kur e vlerëson të arsyeshme mund të kërkojë të intervistojë individin në fjalë. BQK gjithashtu vlerëson përshtatshmërinë e Bordit të Drejtorëve si të tërë dhe jo vetëm anëtarët individualë të tij.
6. Drejtorët dhe Menaxherët e Lartë, duhet të plotësojnë në çdo kohë, kriteret e përcaktuara nga paragrafi 4 i këtij neni. Siç përcaktohet në nenin 35, paragrafi 4, të Ligjit për Bankat, është përgjegjësi e bankës për të njoftuar BQK-në, nëse mëson për ndonjë arsye pse një Drejtor/e ose Menaxher/e i/e Lartë mund të mos jetë më tutje, i/e përshtatshëm dhe i/e duhur në pajtim me Ligjin për Bankat dhe kriteret sipas kësaj rregulloreje.
7. Nëse BQK-ja konstaton se një Drejtor/e apo Menaxher/e i/e Lartë i miratuar nuk është më tutje i/e përshtatshëm dhe i/e duhur, atëherë BQK-ja do të veprojë në pajtim me nenin 36 të Ligjit për Bankat, për largimin e tij nga detyra.
8. Dispozitat e këtij neni që kanë të bëjnë me Drejtorët nuk janë të aplikueshme për degët e bankave të huaja, përveç kërkesave lidhur me Menaxherët e Lartë të cilat aplikohen edhe për degët e bankave të huaja.

Neni 4

Pavarësia lidhur me përgjegjësitë e drejtorit/es

1. Përbërja e Bordit të Drejtorëve duhet të jetë në pajtim me kërkesat e përcaktuara në nenin 26, paragrafi 1, të Ligjit për Bankat. Shumica e këtyre anëtarëve duhet të jenë drejtorë joekzekutivë të pavarur, dhe së paku njëri prej tyre duhet të jetë banor i Kosovës.
2. Kryeshefi/ja ekzekutiv/e shërben në Bordin e Drejtorëve sipas detyrës zyrtare por nuk ka të drejtë vote në Bordin e Drejtorëve dhe nuk llogaritet si anëtar në përbërjen e atij bordi.
3. BQK-ja do ta vlerësojë pavarësinë e një Drejtori/e të propozuar të një banke, në pajtim me nenin 26, paragrafi 3, të Ligjit për Bankat dhe Rregulloren për Qeverisjen Korporative të Bankave.
4. Është përgjegjësi e bankës për të njoftuar BQK-në nëse mëson për ndonjë arsye që një Drejtor/e i/e caktuar si Drejtor/e i/e pavarur mund të mos i përmbush më tutje kriteret e pavarësisë.

Neni 5

Kufizimi për zotërimin e aksioneve

1. Në pajtim me nenin 26, paragrafi 3, të Ligjit për Banka, drejtorët e pavarur mund të mbajnë aksione në bankën në Bordin e të cilës ata shërbejnë, por në nivel të kufizuar, për të ruajtur pavarësinë e tyre.
2. Asnjë drejtor/e i/e pavarur, së bashku me çdo individ të ndërlidhur, nuk mund të mbajë drejtpërdrejt ose tërthorazi më shumë se një (1) përqind të çdo klase të aksioneve me të drejtë vote ose të kapitalit të bankës ose të ndonjë kompanie të grupit pjesë e të cilit është banka.

Neni 6

Vlerësimi nga banka i përshtatshmërisë së Drejtorëve dhe Menaxherëve të Lartë

1. Bankat në proces të licencimit duhet të kujdesen që Drejtorët dhe Menaxherët e saj të Lartë të plotësojnë kriterin “i/e përshtatshëm dhe i/e duhur”, në pajtim me Ligjin për Banka dhe rregulloret e BQK-së.
2. Bankat vazhdimisht duhet të kujdesen që Drejtorët dhe Menaxherët e Lartë i plotësojnë, kriteret “i/e përshtatshëm dhe i/e duhur”, në pajtim me Ligjin për Banka dhe rregulloret e BQK-së, veçanërisht:
 - 1.1. kur ndodhin ndryshimet në përbërjen e Bordit të Drejtorëve, përfshirë:
 - 1.2.1. emërimin e drejtorëve të rinj;
 - 1.2.2. riemërimin e drejtorëve.
 - 1.2. kur ndodhin ndryshime të Menaxherëve të Lartë, përfshirë:
 - 1.3.1. emërimin e Menaxherëve të Lartë të rinj;
 - 1.3.2. riemërimin e Menaxherëve të Lartë.
 - 1.3. kur ekziston dyshimi lidhur me përshtatshmërinë individuale apo kolektive të Drejtorëve dhe Menaxherëve të Lartë;
 - 1.4. në rast të dyshimeve në reputacionin e një ose me shumë Drejtor/e ose Menaxher/e të Lartë, duke përfshirë rastet kur Drejtorët ose Menaxherët e Lartë nuk respektojnë politikat e bankës për konflikt të interesit.
3. Procedurat për riemërimin e Drejtorëve dhe Menaxherëve të Lartë, në pajtim me nenin 26 të Ligjit për Banka ndjekin një procedurë të thjeshtësuar e cila përcaktohet nga Bordi Ekzekutiv me rregullën përkatëse/manualin për licencim.
4. Bankat duhet të sigurojnë parashtrimin në BQK të kërkesave për miratim të emërimit apo riemërimit të një Drejtor/e apo Menaxher/e të Lartë, së paku 60 ditë para datës së paraparë të marrjes (fillimit) të detyrës përkatëse.
5. Bankat duhet rregullisht të monitorojnë plotësimin e kriterit “i/e përshtatshëm dhe i/e duhur” të drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të bankës, për të identifikuar situatat kur rivlerësimi i përshtatshmërisë së tyre duhet të bëhet.
6. Bankat duhet të sigurojnë që Bordi i Drejtorëve, si tërësi të reflektoj diversitet, në çdo kohë, të ketë njohuri, aftësi dhe përvojë adekuate për të kuptuar aktivitetet e bankës, përfshirë rreziqet kryesore.

7. Bankat duhet të vlerësojnë angazhimin e duhur kohor të një Drejtori/e, nëse ky/kjo drejtor/e angazhohet në aktivitete tjera.
8. Dispozitat e këtij neni që kanë të bëjnë me Drejtorët nuk janë të aplikueshme për degët e bankave të huaja, përveç kërkesave lidhur me Menaxherët e Lartë të cilat aplikohen edhe për degët e bankave të huaja.

Neni 7

Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile

Çdo shkelje e kësaj rregulloreje do të jetë subjekt i masave dhe/apo ndëshkimeve administrative në pajtim me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Bankat.

Neni 8

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për Drejtorët dhe Menaxherët e Lartë të Bankave, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore më 31 korrik 2019.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë, nga data e miratimit të saj.

Bashkim Nurboja

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës